



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:061926

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05485139

C.nr.144/2020

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore të paditëses H.S nga fshati Petkoviq, Komuna e Rahovecit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati D.Z nga Prishtina, ndaj të paditurës S, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, me vlerën e objektit të kontestit prej 20,000.00 euro, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 11.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditëses H.S nga fshati Petkoviq, Komuna e Rahovecit.

II. DETYROHET e paditura S me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut më datën 08.02.2020 në fshatin Dobidol, Komuna e Rahovecit, paditësen H.S në emër të dëmit jo material ta kompensojë dhe atë:

- Në emër të dhimbjeve fizike.....3,000.00 euro.
- Në emër të frikës së përjetuar.....3,000.00 euro.
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 2%.....3,000.00 euro.

Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 9,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive, e në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbartimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura S me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut më datën 08.02.2020 në fshatin Dobidol, Komuna e Rahovecit, paditësen H.S, në emër të dëmit material ta kompensojë dhe atë:

- Në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë.....300.00 euro.
- Në emër të ushqimit të përforcuar (30 ditë).....300.00 euro.

Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 600.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 27.02.2020 (data e parashtrimit të padisë), e deri në pagesën definitive, e në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbartim.

V. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses H.S, dhe atë në tërësi në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara për shkak të shëmtimit në shkallën e mesme e dukshme për personat e tretë, në emër të rehabilitimit klimaterik, si dhe përtej shumës së aprovuar si në pikën II, dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

VI. DETYROHET e paditura P me seli në Prishtinë, që paditësit H.S t'ia paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej 909.60 euro po ashtu në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja H.S, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, më datën 27.02.2020 në këtë gjykatë ka parashtruar padinë ndaj të paditurës S, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, me vlerën e objektit të kontestit prej 20,000.00 euro, e precizuar me parashtrësën e datës 20.02.2024.

Paditësja përmes të autorizuarit të saj në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë së parashtruar. Gjykatës, i ka propozuar padinë dhe kërkesëpadinë e precizuar me datë 20.02.2024 ta aprovojë në tërësi, duke marrë parasysh lëndimet e rënda të shkaktuara, që në emër të dëmit material dhe jomaterial, si dhe ta detyrojë të paditurën që të paguajë shumën e përgjithshme prej 20,000.00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 12%, e cila duhet të fillojë nga data e dorëzimit të kërkesës e deri në pagesën përfundimtare.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës Av. M.D, në përgjigjen në padi, në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e baza juridike e kërkesëpadisë nuk është kontestuese, ndërsa të njëjtën e kontestojnë mbi bazën e lartësisë, duke vlerësuar se kërkesa është tejet e lartë dhe në disharmoni me lëndimet e vetë paditëses. I njëjti ka theksuar se sa i përket kamatës së kërkuar prej 12% e kundërshtojnë, pasi që e paditura e ka trajtuar këtë çështje edhe në procedurë jashtëgjyqësore, andaj nuk janë përmbushur kushtet sipas LSDA-së për këtë nivel të kamatës. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e palës paditëse ta aprovojë në nivel të ofertës së dhënë në seancë, ndërsa përtej kësaj shume ta refuzojë si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata ka lejuar ndryshimin e kërkesëpadisë në kuptimin objektiv, konform nenit 258.1 të LPK-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 11.03.2024, sipas propozimit të palëve ka administruar provat dhe atë: raportin policor me nr. ER-056-2020, i datës 08.02.2020 së bashku me skicën e aksidentit; fletëlëshimin me nr. të historisë 163 me datë të pranimit 08.02.2020 dhe datë të lëshimit 12.02.2020, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm Isa Grezda në Gjakovë; udhëzimin për konsultim me nr. serik 0023304 i datës 14.02.2020, me faksimil të Dr. H.M; raportin nga konsulta i datës 12.02.2020 me faksimil të Dr. I.G; dokumentin

mjekësor me nr. vendor 2121 i Repartit të Emergjencës i Spitalit Isa Grezda në Gjakovë; ekspertizën mjekoligjore ortopediko – traumatologjike e Dr. I.S e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 30.11.2023 dhe ekspertizën psikiatrike e Dr. N.F, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 05.02.2024.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 7 dhe 8 i LPK-së, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Ndërmjet palëve nuk ishte kontestues fakti se me datën 08.02.2020, rreth orës 06:58 min, në fshatin Dobidol, Komuna e Rahovecit, është shkaktuar aksidenti i trafikut me dëme materiale dhe jo materiale ndërmjet paditësit dhe të siguruarit të paditëses. Ky fakt është vërtetuar sipas raportit Policor të datës 08.02.2020. Gjithashtu nuk ishte kontestuese as baza juridike e kërkesëpadisë.

Në këtë çështje kontestimore ndërmjet palëve kontestuese është lartësia e kërkesës së paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, po ashtu në këtë çështje juridike ndërmjet palëve kontestuese paraqitet edhe lartësia e kamatës prej 12%.

Me administrimin e raportit policor të datës 08.02.2020, të Stacionit Policor në Gjakovë, gjykata vërtetoi faktin se deri te aksidenti i trafikut të datës 08.02.2020 ka ardhur për shkak të lëshimeve të ngasësit të veturës të markës “Golf”, me targa të regjistrimit 07-998-CR, e siguruar tek e paditura

Me administrimin e ekspertizën mjekoligjore ortopediko – traumatologjike e Dr. I.S e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 30.11.2023 dhe sqarimeve të kësaj ekspertize nga eksperti I.S në seancën e datës 11.03.2024, gjykata vërtetoi faktin se duke u bazuar në raportet mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses me datën 30.10.2023, paditësja në aksidentin e datës 08.02.2020 ka pësuar këto lëndime trupore: ndrydhje të supit të majtë, thyerje të gishtit të majtë. Thyerja e gishtit të majtë - thyerje extraartikulare sipas Benneti, ky lëndim karakterizohet si lëndim i rëndë trupor i cili paditëses i ka shkaktuar: dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë të cilët kanë zgjatur 20 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë të cilët kanë zgjatur për 24 orë (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes), dhimbje fizike të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 21 ditë (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate), si dhe dhimbje fizike të intensitetit të lehtë që kanë zgjatur 1 muaj. Po ashtu është konstatuar se paditësja nuk ka shëmtim trupor. Zvogëlimi të aktivitetit të përgjithshëm jetësor sipas tabelës së BQK-së pika 1.5.10.a -dora jodominante dhe është në shkallën prej 2%. Ndhurma e personit tjetër ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 30 ditëve. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshme deri në 30 dite në kuptim të përzgjedhjes së ushqimit të pasur me proteina minerale dhe vitamina. Rehabilitimi fizioterapeutik nga ana e paditëses është bërë 2 herë nga 10 ditë, dhe atë nga më datë 18.05.2020 – 1.06.2020 dhe nga data 15.06.2020 – 30.06.2020.

Me administrimin e ekspertizën psikiatrike e Dr. N.M.F e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 05.02.2024, gjykata vërtetoi faktin se duke u bazuar në raportet mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses me datën 29.01.2024, paditësja në aksidentin e datës 08.02.2020 ka përjetuar: frikë primare e cila ka zgjatur 2 sekonda në momentin

kur e ka perceptuar mundësin e goditjes nga automjeti dhe si pasojë mundësin e vdekjes, e cila është manifestuar në formë të një britme të fuqishme çjerrëse. Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 24 orëve, të manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti me frikë që shfaqej sa herë përballej me lëndime e pësura dhe mundësin e përjetimeve fatale për vetveten. Kjo ishte manifestuar me pagjumësi, mendime negative, ankth, trishtim, pasiguri, plogështi dhe dridhje të trupit. Frikë sekondare të intensiteti të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 5 muajve, e manifestuar si brengosje e vazhdueshme për gjendjen e saj shëndetësore, nevojën e trajtimit të mëtejshëm mjekësor, si dhe dhimbjet e kohëpaskohshme në trup. Po ashtu gjate kësaj periudhe ka ndjerë ankth, frikë, pagjumësi, pasiguri, ëndrra të frikeshe, mendime të këqija dhe nervozizëm të shtuar, për këtë edhe ka kërkuar ndihme psikiatrike dhe ka përdorur barëra anksiolitike dhe antidepressive me qëllim të lehtësimit dhe të tejkalimit të traumës. Frika sekondare e intensiteti të ulët ka vazhduar rreth një viti, e manifestuar me frikë dhe pasiguri të kohë pas kohe, prishje të gjumit, nervozizëm, disponim të ulur, plogështi, kujtime të shpeshta të aksidentit, si dhe vështirësi të mëdha gjate përfshirjes në aktivitetet lidhur me komunikacionin.

Gjykata vendosi ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit për faktin se sipas vlerësimit të saj në këtë çështje juridike kontestimore kemi të bëjmë me shkaktimin e dëmit material dhe jo material, si pasojë e aksidentit të komunikacionit i shkaktuar si rezultat i lëshimeve të të siguruarit të të paditurës, e që nuk është kontestuar edhe nga e njëjta. Baza juridike e kërkesëpadisë buron nga neni 136 i LMD-së, ku parashihet se *“Kush i shkaktonte dëmin ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Ndërsa neni 140 e të njëjtit ligj parasheh se *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*. Po ashtu, në nenin 159 par. 1 të LMD-së *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”*.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë në lidhje me dëmin jomaterial, gjykata ka vendosur që këto lëndime trupore të i trajtojë si lëndime të rënda trupore për shkakun se nga ekspertiza e ekspertit ortoped – traumatolog, Dr. I.S, këto lëndime janë kategorizuar si lëndime të rënda trupore. Në këtë rast, gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për faktin se shumata e vendosura të jenë një satisfaksion për paditësin dhe se këto shumata janë vendosur në pajtueshmëri të plotë me praktikën gjyqësore. Në këtë rast, gjykata vendosi ta aprovojë kërkesëpadinë në emër të dhimbjeve fizike në shumën prej 3,000.00 euro, për shkak se lëndimet e marra nga paditësi në këtë aksident cilësohen si lëndime të rënda trupore, e në bazë të ekspertizës, paditësi dhimbjet fizike me intensitet posaçërisht të rëndë ka pasur për 30 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë kanë zgjatur për 24 orë, dhimbjet fizike të intensitetit të mesëm kanë zgjatur për 21 ditë dhe dhimbje fizike të intensitetit më të ulët kanë zgjatur 1 muaj.

Gjithashtu, gjykata vendosi ta aprovojë kërkesëpadinë në emër të frikës së përjetuar në shumën prej 3,000.00 euro për shkak se paditësja në momentin e aksidentit ka përjetuar frikë primare në formë të frikës nga vdekja, e manifestuar në formë të një britme të fuqishme çjerrëse, që ka zgjatur rreth 2 sekonda. Ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur për 24 orë me manifestim si shqetësim intensiv nga rasti me frikë që shfaqej sa herë që përballej me lëndimet e pësura dhe mundësinë e përjetimeve fatale për vetveten, të manifestuara me pagjumësi, mendime negative, ankth, trishtim, pasiguri, plogështi dhe dridhje të trupit. I njëjti

gjithashtu ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur për 1 muaj dhe frikë të intensitetit të ulët që ka zgjatur për 1 vit. Në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 2%, gjykata ka vendosur që ta aprovojë kërkesëpadinë në shumën prej 3,000.00 euro, për shkak nga eksperti gjatë ekzaminimit të paditëses është konstatuar se ka pasur kufizim të lëvizjeve konkretisht të 1/3 të saj, në nyjën e parë të gishtit të parë të dorës së majtë, si përfundim është konstatuar se është dorë jodominante. Baza juridike e vendosjes në lidhje me lartësinë e shpërblimit buron në nenin 183 par.1 të LMD-së, sipas të cilit *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*, ndërkaq sipas nenit 174 të LMD-së përcaktohet që *“Gjykata duke marr parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues”*. Me rastin e vendosjes në lidhje me lartësinë e shpërblimit të dëmit, gjykata kishte parasysh edhe shkallën e dëmit që i është shkaktuar paditësit, ndërsa kjo buron në nenin 183 par.2 të LMD-së, sipas të cilit *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Për të gjitha këto kategori, duke u bazuar në ekspertizat mjekësore, për shpërblimin e dëmit në rastin konkret gjykata ka vendosur sipas çmuarjes së lirë, e kjo duke u bazuar në nenin 323 të LPK-së, sipas të cilit *“Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë”*. Lidhur me kamatën, kjo gjykatë është mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Sa i përket dëmit material, gjykata ka vendosur që ta aprovojë kërkesëpadinë deri në shumën prej 600.00 euro dhe atë në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë shumën 300.00 euro, në emër të ushqimit të përforcuar (30 ditë) shumën prej 300.00 euro. Gjykata me rastin e vendosjes po ashtu ka marr për bazë edhe tërë dokumentacionit mjekësor që i janë bashkangjitur shkresave të lëndë.

Gjykata ka vendosur si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e refuzuar pjesën e kërkesëpadisë, në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara për shkak të shëmtimit në shkallën e mesme e dukshme për personat e tretë, për faktin se sipas ekspertizës ortopediko – traumatologjike është konstatuar se paditëses në aksidentin e datës 08.02.2020 nuk i është shkaktuar asnjë shëmtim trupor. Po ashtu, gjykata ka vendosur si në pikën V të dispozitivit për faktin se sipas vlerësimit të saj me shumat e aprovuara në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, arrihet satisfaksioni i nevojshëm në lidhje me dëmin që i është shkaktuar paditësit në aksidentin që është objekt i këtij kontesti. Vlerat e aprovuara janë në harmoni të plotë me

pritsmërinë e krijuar në rastin konkret, prandaj edhe ka vendosur që ta refuzojë shumën përtej shumës së aprovuar. Me rastin e vendosjes, gjykata pati për bazë shkallën e lëndimit, natyrën e lëndimit, moshën e paditësit që në rastin konkret është i dëmtuar, por që shuma e kërkuar është dukshëm më e lartë nga ajo që gjykata vlerëson se në rastin konkret do të jetë satisfaksion për dëmin e shkaktuar.

Gjykata gjithashtu e refuzoi kërkesëpadinë e paditëses për pjesën që ka të bëjë me rehabilitimin klimaterik për faktin se e paditura në këtë çështje kontestimore nuk e ka sjellë asnjë provë me të cilën vërtetohet se e njëjta ka qenë në shfrytëzimin e rehabilitimit klimaterik. Prandaj si e tillë nuk mund të vërtetohet.

Gjykata refuzoi kërkesën e përfaqësuesit të paditëses, që të detyrohet e paditur ta paguaj kamatën ligjore në lartësi prej 12%, në bazë të LSDA-së. Në Ligjin nr. 04/l-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, në nenin 26 par. 1 përcaktohet “Siguruesi është i detyruar që, për dëmet në persona, më së largu në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, ndërsa për dëme në pasuri, më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar me”, pika 1.1. ofertën për dëmshpërblim me shpjegime përkatëse dhe pika 1.2. vendimin dhe arsyet ligjore të refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, kur janë kontestuese përgjegjësia dhe lartësia e dëmit. Ndërsa në nenin 26 par. 6 përcaktohet “Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim”. Në rastin konkret paditësja nuk i ka ofruar gjykatës asnjë provë me të cilën vërtetohet se e njëjta i është drejtuar të paditurës lidhur me kompensimin e dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e trafikut. Pasi që nuk ka prova konkrete me të cilën do të vërtetohej se paditësja i është drejtuar të paditurës lidhur me kompensimin e dëmit e dëmit të shkaktuar në aksident, se e paditura ka dështuar ti respektoj afatet e parapara ligjore lidhur me trajtimin e kërkesës së paditëses, gjykata ka vendosur që lartësia e kamatës vjetore të jetë prej 8%, sipas LMD-së.

Gjykata ka analizuar edhe provat tjera dhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, mirëpo të njëjtat nuk kanë impakt në vendosjen ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me lartësinë e kamatës është marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë, e duke u bazuar në dispozita të neneve 136, 140, 159 dhe 183 të LMD-së, vlerësojë se e paditura është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar paditëses me rastin e shkaktimit në aksidentin e trafikut, dhe duke u mbështetur në dispozitat e neneve 143, 323, dhe 390 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimin në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata e morri duke u mbështetur në dispozitat e neneve 449 dhe 452.1 të LPK-së, shumën e përgjithshme prej 909.60 euro dhe atë për përpilimin e padisë 104.00 euro, për tre seanca gjyqësore me nga 135.20 euro për secilën në shumën e përgjithshme prej 405.60, në emër të dy ekspertizave mjekësore shumën prej 300.00 euro dhe taksën për padi në shumën prej 100.00 euro.

Nga të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.144/2020, më datë 11.03.2024

Bashkëpunëtore profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.